



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202300340/2

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2023

**Lënda :** *Rekomandojmë marrjen e masave për disa ndryshime legislative, me theks parandalimin e seksizmit në media dhe trajtimin e problemeve të gjeneruara nga ky fenomen.*

MINISTRISË SË KULTURËS  
MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE  
KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI  
KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE  
AUTORITETIT TË MEDIAVE AUDIOVIZIVE  
INSTITUTIT TË STATISTIKAVE

**Për dijeni:** KUVENDIT TË SHQIPËRISË

**TIRANË**

*Të nderuar/Të nderuara,*

Institucioni i Avokatit të Popullit, si një institucion i pavarur, në ushtrimin e funksioneve të tij sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Ligjit Nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, ka një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike.

Adresimi i shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe interesave të tjera të ligjshme të grave dhe vajzave, si edhe ofrimi i mundësive të barabarta për të gjitha grupet vulnerabël, është pjesë e prioriteteve strategjike të Avokatit të Popullit.

Avokati i Popullit, bazuar në punën e tij të përditshme, ankimet e bëra pranë insitucionit, rastet e ndërmarra me iniciativë, në analizat e kryera lidhur me situatën e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, duke marrë shkas edhe nga studimi “Seksizmi në median audiovizive. Analizë e legjislacionit vendas dhe detyrimi për përafrim legjislacioni me standardet europiane”<sup>1</sup>, konstaton se ka një vazhdimësi mes stereotipeve gjinore, pabarazisë gjinore, seksizmit dhe dhunës ndaj grave dhe vajzave. Një dimension me rëndësi është edhe barazia gjinore dhe seksizmi në media, jo vetëm për shkak se media është një sektor i veprimtarisë së jetës ku shfaqen qasjet seksiste, por për shkak të ndikimit që ajo ka në shoqëri si agjente ndryshimi.

Avokati i Popullit pasi studioi me kujdes raportin dhe analizën e bërë nga ekspertja, pasi përballi gjetjet me të dhënat e tij, e pasi vlerësoi rolin e shoqërisë civile në ngritjen e problematikave të qenësishme të të drejtave të grave, vendosi të përqafojë propozimet e këtij raporti dhe të përforcojë nevojën për të ndryshuar qasjen në lidhje me këto çështje.

Avokati i Popullit konstaton se media audiovizive, në mënyra të ndryshme, përfshirë dhe programet që transmeton, shpesh kontribuon në shkelje të të drejtave të grave dhe vajzave. Steriotipet gjinore, pabarazia, seksizmi dhe dhuna ndaj grave dhe vajzave, shfaqen herë pas here nëpërmjet sjelljeve, komenteve dhe shakave seksiste, të cilat edhe pse tentohet të shfaqen si të padëmshme, në fakt janë poshtëruese dhe përuhin gratë dhe vajzat, dinjitetin dhe vetëvlerësimin e tyre. Seksizmi dhe sjellja seksiste rezultojnë në dëmtime psikologjike ose socio-ekonomike, në disa raste edhe fizike e seksuale. Këto ndikojnë në mënyra të ndryshme në grupe të caktuara të popullatës.

Gratë dhe vajzat preken në mënyrë sproporcionale nga sjellje të tilla. Megjithatë, gratë që sfidojnë ose devijojnë nga ajo që vlerësohet si vendi i tyre "i duhur" në shoqëri, mund të përballen me seksizëm dhe misogjeni, po ashtu edhe burrat që sfidojnë perceptimet mbizotëruese për maskulinitetin, mund të përballen me seksizëm.

---

<sup>1</sup> Vlerësimi është kryer nga AWA, në kuadër të Projektit “Harmonizimi i legjislacionit kombëtar lidhur me seksizmin në median audiovizive me EU acquis”, mbështetur nga REACTOR - Research in Action dhe partnerët e tyre nëpërmjet Aksionit "Të çojmë përpara barazinë gjinore nëpërmjet procesit të integritit evropian", financuar nga Bashkimi Evropian dhe Qeveria Suedeze.

<https://vizionalsherbim.website/albanianwomaninaudiovisual.com/wp-content/uploads/2021/11/studimi-arsyetimi-ligjor-per-propozimet-ligjore-AWA.pdf>

Gjithashtu, gratë dhe burrat mund të ballafaqohen me forma të ndryshme dhe të ndërthurura të seksizmit, bazuar në një sërë faktorësh të tjerë duke përfshirë, mes të tjerash, etninë, statusin e të qenit pakicë ose autokton, moshën, fenë, statusin e refugjatit ose emigrantit, aftësinë e kufizuar, statusin martesor, origjinën sociale, identitetin gjinor, orientimin seksual.

Përsa i përket përfaqësimit gjinor dhe shfaqjes përmbajtësore të dimensionit gjinor në median audiovizive në vend, Avokati i Popullit konstaton se:

- ✓ Gratë e vajzat janë më pak të pranishme në emisionet, që transmetohen në median audiovizive krahasuar me burrat dhe djemtë.
- ✓ Gratë e vajzat përbëjnë grupin më të madh të prekur nga fjalime me gjuhë urrejtje, seksiste apo diskriminuese në përgjithësi.
- ✓ Pabarazia gjinore nuk trajtohet në temat e lajmeve dhe ka mungesë të perspektivës gjinore në trajtimin e lajmeve nga të gjitha fushat.
- ✓ Gratë e vajzat janë më pak të pranishme në institucionet rregullatore të medias audiovizive.
- ✓ Institucionet rregullatore të medias audiovizive në Shqipëri, nuk përgatisin studime apo raporte mbi barazinë gjinore në median audiovizive apo studime/raporte lidhur me median gjinore.
- ✓ Nuk është i mundur ligjërisht hetimi *ex officio* për rastet e seksizmit në mediat audiovizive.
- ✓ Nuk ka ndonjë rregullim ligjor që të parashikojë sanksione për seksizmin në mediat audiovizive.

Indeksi Gjinor për Republikën e Shqipërisë, 2020, duke iu referuar fushës së pushtetit na tregon se: *“pushteti social i grave, d.m.th. përfaqësimi në organet e bordeve organizative të kërkimeve shkencore, financimit, medias dhe sporteve kryesore mbetet prapa me progresin në pushtetin politik dhe ekonomik”*.

Referuar studimit *“Dhuna ndaj grave në politikë”*<sup>2</sup>, *gratë më shumë se burrat janë përballur gjatë fushatave zgjedhore me gjuhë seksiste dhe diskriminuese si dhe kanë qenë pre e lajmeve të rreme.*

Ndërsa seksizmi në media është i pranishëm në vendin tonë, Avokati i Popullit konstaton se nevojitet që kjo çështje të adresohet, si çështje e të drejtave themelore të njeriut, në kuadrin ligjor kombëtar, për të cilin vëren se ka boshllëqe.

---

<sup>2</sup> Studimi *“Dhuna ndaj grave në politikë”*, kryer në partneritet midis Avokatit të Popullit dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur nga UNDP në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara *“T”* i japim fund Dhunës ndaj Grave në Shqipëri”, financuar nga Qeveria e Suedisë, lançuar më 6 prill 2022.

Linku: <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/VIOLENCE%20AGAINST%20WOMAN%20IN%20POLITIC.pdf>  
<https://www.undp.org/albania/publications/violence-against-women-politics>

Në këtë kuptim, lufta kundër seksizmit është pjesë e detyrimit pozitiv të shtetit për të garantuar të drejtat e njeriut, barazinë gjinore dhe për të parandaluar dhunën ndaj grave dhe vajzave në përputhje me dokumentat ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Duke njohur se “seksizmi është një manifestim i marrëdhënieve historikisht të pabarabarta të pushtetit midis grave dhe burrave, që çon në diskriminim dhe pengon avancimin e plotë të grave në shoqëri”,<sup>3</sup> institucionet e Bashkimit Evropian, Këshillit të Evropës, Kombet e Bashkuara, e kanë trajtuar drejtpërdrejtë seksizmin në media për shkak të rolit të posaçëm që ai ka në shoqëri, duke kërkuar që legjislacionet e vendeve të përfshijnë rregulla dhe sanksione për sjelljet seksiste.

*Konventa e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW)*, ka në vëmendje aspekte të thelluara të stereotipeve gjinore dhe seksizmin ndaj grave e vajzave, duke adresuar edhe aktet e seksizmit "të përditshëm".

*Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut* ndalon të gjitha llojet e diskriminimit, duke përfshirë edhe diskriminimin për shkak të gjinisë.

*Sipas Këshillit të Evropës*, barazia gjinore është një parakusht për të drejtat e njeriut, demokracinë dhe drejtësinë sociale; ajo sjell përfitime për të gjithë shoqërinë. *Media dhe liria editoriale, pluralizmi i medias dhe barazia gjinore mund ta çojnë përpara njëra-tjetrin*. Këshilli i Evropës ka miratuar një sërë rezolutash dhe rekomandimesh, që adresojnë posaçërisht barazinë gjinore dhe seksizmin në media.

*Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit)*, ka të njëjtën qasje. Ndërsa Grupi Ekspertëve GREVIO, pasi ka evidentuar se dhuna ndaj grave në sferën dixhitale ka pësuar një rritje globale, me pasoja të rënda ka miratuar në nëntor 2021 Rekomandimin Nr.1 “Dimensionet dixhitale dhe dhuna ndaj grave”.

*Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës* miratoi më 27 mars 2019, Rekomandimin CM/Rek (2019)1 “Për parandalimin dhe luftën kundër seksizmit”, i cili adreson seksizmin në media<sup>4</sup>. Në këtë rekomandim theksohet se: “seksizmi dhe sjellja seksiste rezultojnë në dëmtime fizike, seksuale,

---

<sup>3</sup> Rekomandimi CM/Rec(2019)1 i miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, 27 mars 2019.

<sup>4</sup> *Për qëllime të këtij Rekomandimi, seksizmi nënkupton*: “Çdo veprim, gjest, paraqitje vizuale, fjalë të thëna ose të shkruara, praktikë ose sjellje të bazuar në idenë se një person ose një grup personash është inferior për shkak të gjinisë së tyre, që ndodh në sferën publike ose private, qoftë online apo offline, me qëllim ose efekt:

i. të shkeljes së dinjitetit ose të drejtave thelbësore të një personi ose një grupi personash;

ose

ii. që rezulton me dëm fizik, seksual, psikologjik ose socio-ekonomik ose vuajtje për një person ose një grup personash; ose

iii. të krijimit të një mjedisi frikësues, armiqësor, poshtërues, ofendues ose fyes; ose

iv. të krijimit të një pengese për autonominë dhe realizimin e plotë të të drejtave të njeriut nga një person ose një grup personash; ose

v. ruajtjes apo forcimit të stereotipeve gjinore

*psikologjike ose socio-ekonomike dhe ndikojnë ndryshe në grupime të ndryshme të popullsisë. Gratë dhe vajzat preken në mënyrë joproporcionale nga një sjellje e tillë”.*

*Direktiva 2018/1808/EU “Mbi koordinimin e disa dispozitave të përcaktuara me ligj, rregullore ose veprime administrative në Shtetet Anëtare në lidhje me ofrimin e shërbimeve mediatike audiovizive (Direktiva për Shërbimet Mediatike Audiovizive), në funksion të ndryshimit të realiteteve të tregut” të 14 nëntorit 2018, të Këshillit të BE-së, që ndryshoi Direktivën 2010/13/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 10 mars 2010 “Për bashkërendimin e disa dispozitave të përcaktuara me ligj, rregullore ose veprim administrativ në Shtetet Anëtare në lidhje me ofrimin e shërbimeve mediatike audiovizive”, e cila është një direktivë e dedikuar për shërbimet mediatike audiovizive.<sup>5</sup>*

Me Ligjin Nr.13/2022, u ratifikua nga Kuvendi i Shqipërisë, Konventa Nr.190 e ILO<sup>s</sup> “Dhuna dhe ngacmimet në botën e punës”, e cila gjithashtu kërkon përafrimin e legjislationit vendas me standardet, që kjo Konventë sjell për mbrojtjes e punonjësve edhe nga shfaqje të tilla si seksizmi.

Në këtë këndvështrim, pasqyrimi në legjislationin tonë, i kërkesave që burojnë nga këto akte, është detyrim. Po ashtu, duke konsideruar prioritetin politik të realizimit të integritetit të plotë evropian të vendit, harmonizimi i legjislationit tonë me atë të Bashkimit Evropian për të luftuar seksizmin në media bëhet po aq detyrim.

Ndërsa kuadri politik i vendit e adreson barazinë gjinore si çështje të zhvillimit të shoqërisë, Strategjia Kombëtare e Barazisë Gjinore 2021-2030, vetëm në Objektivin II.1.5. “Fuqizimi i kapaciteteve të medias, për të paraqitur modele pozitive të grave, të rejave dhe vajzave lidere nga të gjithë grupet”, parashikon një ndërlidhje mes aspekteve të barazisë gjinore dhe medias, pa parashikuar masa të cilat të jenë të lidhura me eliminimin e seksizmit në media<sup>6</sup>.

Po ashtu, në Planin Kombëtar të Integritetit Evropian 2022-2024, nuk ka asnjë masë që të synojë harmonizimin e legjislationit vendas me të drejtën e BE<sup>së</sup> në fushën e barazisë gjinore në median audio-vizive, përse i përket luftës kundër seksizmit në media.

Legjislationi vendas për mediat audiovizive nuk përfshin rregulla specifike për seksizmin në mediat audiovizive. Megjithëse është rregulluar me ligj barazia gjinore në shoqëri (Ligji nr. 9970, datë 24.7.2008 "Për Barazinë Gjinore në Shoqëri")<sup>7</sup> si dhe lufta kundër dhunës me bazë gjinore, barazia gjinore në media ende nuk ka një rregullim të rëndësishëm. Ligjet, si:

---

<sup>5</sup> Gazeta Zyrtare, BE, L 95, 15.4.2010, fq. 1. Shih tekstin e konsoliduar në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A02010L0013-20181218>

<sup>6</sup> VKM nr. 400, datë 30.6.2021, “Për miratimin e strategjisë kombëtare për barazinë gjinore, 2021–2030, dhe të planit të saj të veprimit”. Shih në: <http://qbz.gov.al/eli/vendim/2021/06/30/400>

<sup>7</sup> Shih në: <http://qbz.gov.al/eli/ligj/2008/07/24/9970>

- Kodi i Transmetimit për mediat audiovizive<sup>8</sup>
- Ligji nr. 8096, datë 21.03.1996 “Për kinematografinë”, i ndryshuar,<sup>9</sup>
- Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", i ndryshuar,<sup>10</sup> si dhe
- Ligji nr. 9970, datë 24.7.2008 "Për Barazinë Gjinore në Shoqëri",
- Ligji nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.<sup>11</sup>

nuk përfshijnë seksizmin në media në dispozitat për median ose disa prej tyre nuk përfshijnë dispozita, që të adresojnë efektivisht aspektet e barazisë gjinore.

Së fundmi, Kuvendi i Shqipërisë miratoi Ligjin Nr.30/2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar <sup>12</sup>, i cili përfshiu përkufizimin e seksizmit në pikën 36/1 të Nenit 3 “Përkufizime”, sipas së cilit “*Seksizëm*” është çdo akt, veprim, gjest, përfaqësim vizual, fjalë të shkruara ose të thëna në median audiovizive, praktika ose sjellje të bazuara në idenë se një person ose grup personash është inferior për shkak të gjinisë, që ndodh në sferën publike ose private, online ose offline, me efekt dhe qëllim dhunimin e dinjitetit të njeriut, të drejtat dhe liritë themelore të një personi apo grupi personash, shtetas shqiptarë, të huaj apo pa shtetësi, që rezulton në dëm ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose socio-ekonomike ndaj një personi apo grupi personash, shtetas shqiptarë, të huaj apo pa shtetësi ose që krijon apo ushqen krijimin e një mjedisi që ngjall frikë, armiqësor, degradues, fyes ose poshtërues, ose ushqen apo synon ruajtjen dhe përforcimin e stereotipeve gjinore.”

Megjithatë, një sërë ndryshimesh të tjera, janë të nevojshme të përfshihen në dispozita të caktuara të këtij ligji.

Kodi i Transmetimit për mediat audiovizive nuk e përmend legjislacionin për barazinë gjinore në bazën e tij ligjore. Edhe pse Ligji për Barazinë Gjinore në shoqëri pranon se, media ndihmon në rritjen e ndërgjegjësimit të përgjithshëm për barazinë e grave dhe burrave nëpërmjet raportimit jodiskriminues në bazë të gjinisë, përdorimit të terminologjisë neutrale ndaj gjinisë dhe shmangies së stereotipeve gjinore në aktivitet, ai nuk përfshin ndonjë kërkesë ligjore për publikimin e raporteve institucionale për të matur shfaqjen e seksizmit në media apo më shumë akoma ndikimin e saj në çështjen e barazisë gjinore.

<sup>8</sup> Shih në: <http://ama.gov.al/wp-content/uploads/2018/05/Kodi-i-Transmetimit-p%C3%ABr-Median-Audiovizive.pdf>

<sup>9</sup> Shih në: <http://qzb.gov.al/eli/ligj/1996/03/21/8096>

<sup>10</sup> Shih në: <http://qzb.gov.al/eli/ligj/2010/02/04/10221>

<sup>11</sup> Shih në: <http://qzb.gov.al/eli/ligj/2008/12/29/10019>

<sup>12</sup> Shih në: [202304201406224054ligj nr. 30, dt. 13.4.2023.pdf](http://202304201406224054ligj_nr_30_dt_13.4.2023.pdf) (parlament.al)



Realiteti tregon se edhe ato rregullime të kufizuara ligjore nuk kanë sjellë ndryshime pozitive, duke na treguar se këto rregulla nuk mjaftojnë.

Edhe Kodi Etik i Gazetarit,<sup>13</sup> si një mekanizëm vetëkontrolli i gazetarisë, edhe pse përfshin në pikën 8 të tij aspekte të gjuhës së urrejtjes, nuk e adreson çështjen e seksizmit në media në tërësinë e vet.

Ndaj, Avokati i Popullit konsideron se rol të rëndësishëm drejt përparimit të barazisë gjinore ka dhe media në përgjithësi dhe ajo audiovizive në veçanti, duke patur këtu parasysh ndikimin që ajo ka në publikun e gjerë dhe rolin, që mund dhe duhet të luajë si agjente ndryshimi, nëpërmjet portretizimit dhe paraqitjes së modeleve pozitive të grave dhe vajzave, larg stereotipeve gjinore.

Për sa më sipër, Avokati i Popullit në vijim të kryerjes së misionit ligjor në rolin e nxitësit të standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend, bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; si dhe nenin 24/a të Ligjit 8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar sipas së cilit: *“Kur Avokati i Popullit vëren se është vetë përmbajtja e ligjit ose e akteve të tjera normative dhe jo zbatimi i tyre, shkaku që krijon premisa për shkelje të të drejtave të njeriut, të njohura nga Kushtetuta ose ligjet e tjera, ka të drejtë: a): t’u rekomandojë organeve që kanë të drejtën ligjvënëse të bëjnë propozime për ndryshimin dhe përmirësimin e ligjeve”*,

## **REKOMANDOJMË:**

Marrjen e masave nga insitucionet përgjegjëse, që kanë iniciativën legjislativë për të propozuar ndryshimet ligjore, sipas paketës ligjore, me fokus eliminimin e seksizmit në mediat audiovizive, si më poshtë:

---

<sup>13</sup> Kodi Etik i Gazetarit, Pika 8. Gjuha e Urrejtjes:

Media duhet të mos botojë materiale që nxisin urrejtje apo dhunë ndaj individëve mbi bazën e racës, fesë, kombësisë, ngjyrës, origjinës etnike, anëtarësisë, gjinisë, orientimit seksual, statusit civil, paaftësisë, sëmundjes apo moshës.

Çdo botim duhet të mos specifikojë origjinën, etnicitetin, kombësinë, racën, fenë apo orientimin seksual të një grupi apo individ, përveç rasteve kur gjykohet e rëndësishme dhe e nevojshme për të kuptuar më mirë faktet dhe opinionet e paraqitura në publikim.

Shih tekstin në: <https://www.osce.org/files/f/documents/d/7/21235.pdf>

1. Në Ligjin Nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të përfshihen aspekte të barazisë gjinore dhe luftës kundër seksizmit në median audiovizive, si vijon:

- ✓ Në Nenin 4 “Parimet themelore për veprimtarinë e transmetimeve audiovizive”, pika 2 shtohet shkronja (dh) me përmbajtjen: *“parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit gjinor, ndalimit të seksizmit në media, dhe përfaqësimit gjinor në median audio-vizive, në përputhje me legjislacionin në fuqi”*.
- ✓ Në nenin 9 “Zgjedhja e anëtarëve/anëtareve të AMA-s”, rekomandohet të shtohet një fjali në fund të pikës 1, me qëllim garantimin e barazisë gjinore në median audiovizive, me përmbajtjen: *“Kuvendi, në zgjedhjen e anëtarëve/anëtareve të AMA-s respekton parimin e barazisë gjinore për përfaqësim të drejtë gjinor, duke garantuar që të paktën 30% e tyre t’i përkasë një gjinie”*.
- ✓ Në nenin 20, “Këshilli i Ankesave”, rekomandohet të shtohet fjalia me përmbajtjen: *“Këshilli i Ankesave garanton respektimin e dinjitetit të njeriut, të drejtat dhe liritë themelore të një personi apo grupi personash, shtetas shqiptarë, të huaj apo pa shtetësi, duke garantuar ruajtjen e imazhit nga qasjet seksiste në programet audiovizive”*
- ✓ Të shtohet Neni 30/1 me përmbajtjen si vijon:

1. *“AMA përgatit dhe rishikon Kodet e Sjelljes që përcaktojnë standardet dhe praktika, që duhet të respektohen nga ofruesit e shërbimeve mediatike që ofrojnë shërbime mediatike audio dhe audiovizive. Kodet e Sjelljes hartohen në mënyrë që të:*

- a. kenë përmbajtje gjerësisht të pranueshme nga palët e interesit;*
- b. përcaktojnë në mënyrë të qartë dhe të padyshimtë objektivat e tyre;*
- c. garantojnë respektimin e dinjitetit të njeriut, të drejtat dhe liritë themelore të një personi apo grupi personash, shtetas shqiptarë, të huaj apo pa shtetësi;*
- ç. parashikojnë një monitorim dhe vlerësim të rregullt, transparent e të pavarur të arritjes së objektivave të synuara; si dhe*
- d. sigurojnë një zbatim efektiv, përfshirë sanksione të efektshme dhe proporcionale.*

2. *Ofruesit e shërbimeve audiovizive hartojnë dhe zbatojnë Kode Sjelljeje si marrëveshje të lira mes tyre, për të zbatuar kërkesa etike dhe profesionale në ushtrimin e detyrës dhe detyrimet ligjore të parashikuara në këtë ligj, në favor të rritjes së cilësisë dhe shumëllojshmërisë së programeve audiovizive.*



*Kodet e Sjelljes publikohen dhe në faqet elektronike të ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizive”.*

✓ Pika 4 e nenit 32, sugjerohet të riformulohet : *“Ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive nuk transmetojnë programe me përmbajtje që nxisin dhunë ose urrejtje kundrejt një grupi personash ose një anëtarit të një grupi mbi baza të tilla si gjinia, identiteti gjinor, orientimi seksual, karakteristikat e seksit, raca, ngjyra, origjina etnike ose shoqërore, tiparet gjenetike, gjuha, feja, besimi, opinioni politik, kombësia, anëtarësimi i një pakice kombëtare, prona, lindja, paaftësia, mosha ose orientimi seksual, gjininë, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

✓ Në nenin 33 “Detyrimet e OSHMA-ve” rekomandohet të shtohen gërmat gj) dhe h) si vijon:

*gj) marrin masa proporcionale me qëllim mos transmetimin e programeve audio dhe audiovizive që pasqyrojnë sjellje seksiste, objektifikuese, stereotipizuese, degraduese ose fyese duke reaguar menjëherë me qëllim dënimin e hapur dhe publik të këtyre sjelljeve dhe duke u distancuar nga këto sjellje në rastet e transmetimeve të drejtpërdrejta si dhe duke mbyllur programin, kur kjo është e mundur, ose duke mos transmetuar programet në rastet kur janë jo të drejtpërdrejta.*

*h) ndalojnë reklamat apo fushatat mediatike, përfshirë edhe ato zgjedhore, që pasqyrojnë sjellje seksiste, objektifikuese, stereotipizuese, degraduese ose fyese.*

✓ Në nenin 42 “Komunikimet me natyrë tregtare” rekomandohet të shtohet në fund të pikës 6 togfjalëshi me përmbajtjen : *“Komunikimet me natyrë tregtare në transmetimet audiovizive për produkte të cilat pasqyrojnë materiale seksiste, objektifikuese dhe stereotipizuese janë të ndaluara.”*

✓ Në nenin 46 “Kodi i transmetimit” rekomandohet pasqyrimi i detyrimeve si vijon duke shtuar pikat dh/1 dhe ë/1:

*dh/1) programet audio dhe audiovizive që pasqyrojnë sjellje seksiste, objektifikuese, stereotipizuese, degraduese ose fyese të kenë reagimin e menjëhershëm me qëllim dënimin e hapur dhe publik të këtyre sjelljeve dhe distancimin e OSHME-ve nga sjellje të tilla në rastet e transmetimeve të drejtpërdrejta, si dhe mos transmetimin e tyre në rastet e programeve jo të drejtpërdrejta.*

ë/1) reklamat apo fushatat mediatike, përfshirë edhe ato zgjedhore, të mos pasqyrojnë sjellje seksiste, objektifikuese, stereotipizuese, degraduese ose fyese.

- ✓ Në nenin 94 “Zgjedhja e anëtarëve/anëtarëve AMA-s” rekomandohet që në pikën 1 të shtohet një fjali, që garanton barazinë gjinore në median audiovizive, si vijon: “...në respektim të parimit të barazisë gjinore”
- ✓ Në nenin 94 “Zgjedhja e Anëtarëve të KDRTSH”, në fund të pikës 3 të shtohet fjalia me përmbajtjen si vijon: “Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik në zgjedhjen e anëtarëve respekton paraimin e barazisë gjinore për përfaqësim të drejtë gjinor, duke garantuar që të paktën 30% e anëtarëve t’i përkasë një gjinie”

- ✓ Në nenin 133, rekomandohet të shtohen sanksionet si vijon:

*Shtohet pika 8/1, me përmbajtje si vijon:*

*“Me gjobë nga 40 000 deri në 400 000 lekë për rastet kur nuk respektohet detyrimi për reagim të menjëhershëm nga ana e OSHME-ve sipas germës gj) neni 33 të këtij ligji si dhe detyrimin për vendosje të reagimit në media në fashat orare me të ndjekura”*

Në pikën 9 të nenit 133 shtohet germa c), si vijon:

*“AMA vendos pezullimin e përkohshëm të liçencës dhe/ose autorizimit në rast se subjekti: a) shkel detyrimin e mostransmetimit të programeve sipas germës gj) dhe h) të nenit 33 të këtij ligji”*

2. Në Ligjin Nr. 8096, datë 21.03.1996 “Për kinematografinë”, i ndryshuar, rekomandohen të bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijon:

- ✓ Në nenin 4 shtohet pika 16, me përmbajtjen: “Realizon detyrat e përcaktuara në pikat 1 deri 15 duke garantuar përfshirje të secilës gjini në shpërndarjen e fondeve, miratimin e projekteve, përcaktimin e fondeve, propozimet ligjore e nënligjore, kualifikimet profesionale, regjistrimet, kontrollin, analizimin dhe shqyrtimin e çdo projekti, miratimin e raporteve, dhe mbështetjet financiare”
- ✓ Në nenin 8, të bëhen këto ndryshime:
  - Në fund të fjalisë së dytë të shtohet togfjalëshi: “...dhe kanë në përbërje të paktën 30% të anëtarëve të të njëjtës gjini.
  - Në fund të fjalisë së pestë të shtohet togfjalëshi: “...ku të paktën 30% e tyre i përkasin të njëjtës gjini”

Në Ligjin Nr. 8096, datë 21.03.1996 “Për kinematografinë”, i ndryshuar, përcaktohet se Qendra Kombëtare e Kinematografisë (QKK) ka edhe Statutin

dhe Rregulloren e vet. Në to sugjerohen ndryshimet si vijon:

- ✓ Në nenin 12, në fjalinë e fundit të pikës 6 të Statutit të QKK<sup>së</sup>, pas togfjalëshit “provokojnë urrejtjen sociale, racore ose çdo formë tjetër diskriminimi” të shtohet togfjalëshi “përfshirë atë me bazë gjinore dhe qasje seksiste.
- ✓ Në fund të Kapitullit IV, “Këshillat dhe Komisionet”, të rregullores së QKK<sup>së</sup>, të shtohet fjalia “Të paktën 30% e anëtarëve të këtyre Këshillave dhe Komisioneve i përket një gjinie”.
- ✓ Në Kapitullin V, “Mënyra e përzgjedhjes së projekteve kinematografike”, të rregullores së QKK, sugjerohet që në fjalinë e dytë, në fund të pikës 1, të shtohet fjalia “Çdo prezantim përfshin edhe qasjen gjinore në projekt”.

3. Në Ligjin Nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", i ndryshuar, rekomandohet të bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijon:

- ✓ Në nenin 3, “Përkufizimet, të përfshihet përkufizimi i seksizmit në media si vijon:

*“Seksizëm” është çdo akt, veprim, gjest, përfaqësim vizual, fjalë të shkruara ose të thëna në median audiovizive, praktika ose sjellje të bazuara në idenë se një person ose grup personash është inferior për shkak të gjinisë, që ndodh në sferën publike ose private, online ose offline, me efekt dhe qëllim dhunimin e dinjitetit të njeriut, të drejtat dhe liritë themelore të një personi apo grupi personash, shtetas shqiptarë, të huaj apo pa shtetësi, që rezulton në dëm ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose socio-ekonomike ndaj një personi apo grupi personash, shtetas shqiptarë, të huaj apo pa shtetësi ose që krijon apo ushqen krijimin e një mjedisi që ngjall frikë, armiqësor, degradues, fyese ose poshtërues, ose ushqen apo synon ruajtjen dhe përforcimin e stereotipeve gjinore.*

- ✓ Neni 8 “Reklamat diskriminuese”, sugjerohet të ndryshohet si vijon:

*“Ndalohet publikimi në cilindo format, përfshirë median audio-vizive, i reklamave, fushatave dhe njoftimeve të ndryshme, nëse ato paraqesin, haptazi apo në mënyrë të nënkuptuar, qëllim për të diskriminuar, për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, apo sjellje seksiste, objektifikuese, stereotipizuese, degraduese ose fyese”*

- ✓ Në nenin 20 “Të mirat dhe shërbimet”, të përfshihet barazia gjinore efektive në media, në pikën 2) shtohet germa gj) me përmbajtjen: *“shërbime të medias së shkruar, audiovizive dhe medial elektronike (online)”*.

- ✓ Në nenin 32, shtohet germa b/1 dhe ndryshon germa l) si vijon:

*b/1) heton me iniciativën e vet raste mediatike e publike të seksizmit në*

*media;*

*l) të zhvillojë aktivitete ndërgjegjësimi dhe edukimi që ndihmojnë në zbatimin e këtij ligji, përfshirë për ndalimin e seksizmit në median audiovizive.*

- ✓ Në nenin 33, pas pikës 17, shtohet pika 17/1 me përmbajtjen “*Operatorët audiovizivë kanë detyrimin të mos shfaqin sjellje apo mosveprim të natyrës seksiste në median e tyre*”

4. Në Ligjin Nr.9970, datë 24.7.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, rekomandohet të bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijon:

- ✓ Në nenin 2 “Qëllimi”, të ndryshohen germat a) dhe c) si vijon:

Në germën a) pas togfjalëshit “të sigurojë mbrojtje efikase nga diskriminimi për shkak të gjinisë” të shtohet togfjalëshi “*dhe seksit, ...*”

Në germën c) pas togfjalëshit “të përcaktojë përgjegjësitë e autoriteteve shtetërore, qendrore dhe vendore,” të shtohet togfjalëshi “*atyre të pavarura dhe subjekteve privatë me ndikim publik, përfshirë edhe operatorët e medias audiovizive, ...*”

- ✓ Në tërësinë e përkufizimeve të Nenit 4 të ligjit, pika 5 të përfshijë edhe median, si vijon:

“Përfaqësim i barabartë gjinor” është përfaqësimi i secilës prej gjinive me jo më pak se 30 për qind në një institucion, në nivel drejtues, organ të emëruar, parti politike, organe drejtuese, *organe drejtuese të medias audiovizive, përfshirë kinematografinë si dhe punonjësit në tërësi në operatorët e mediave audiovizive*”

- ✓ Në nenit 4 të ligjit shtohet pika 11, përkufizimi i seksizmit, si vijon:

“Seksizëm” është çdo akt, veprim, gjest, përfaqësim vizual, fjalë të shkruara ose të thëna në median audiovizive, praktika ose sjellje të bazuara në idenë se një person ose grup personash është inferior për shkak të gjinisë, që ndodh në sferën publike ose private, online ose offline, me efekt dhe qëllim dhunimin e dinjitetit të njeriut, të drejtat dhe liritë themelore të një personi apo grupi personash, shtetas shqiptarë, të huaj apo pa shtetësi, që rezulton në dëm ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose socio-ekonomike ndaj një personi apo grupi personash, shtetas shqiptarë, të huaj apo pa shtetësi ose që krijojnë apo ushqen krijimin e një mjedisi që ngjall frikë, armiqësor, degradues, fytes ose poshtërues, ose ushqen apo synon ruajtjen dhe përforcimin e stereotipeve gjinore.

- ✓ Në nenin 15, pika 1, shtohet germa e) me përmbajtjen: “sigurohet përfshirja mbi 30 për qind të secilës gjini në organet drejtuese, administruese të medias së shkruar dhe audiovizive, përfshirë atë online, si dhe në tërësi në pozicionet e punës në to”.

Neni 26 “Barazia gjinore në media”, ndryshon si vijon:

1. Media e shkruar dhe audio-vizive, si dhe ajo elektronike ndihmon në rritjen e vetëdijes së përgjithshme për barazinë e grave/vajzave dhe burrave përmes:

- a) raportimit jodiskriminues mbi baza gjinore;
- b) përmbajtjes mediatike përfaqësuese dhe jo objektifikuese për të dy gjinitë;
- c) përmbajtjes mediatike jo të dhunshme dhe/ose seksiste, dhe ngacmimit kibernetik;
- c) përdorimit të terminologjisë neutrale në aspektin gjinor dhe një gjuhë jo urrejtje apo seksiste ose që nxit dhunë të motivuar nga gjinia, identiteti gjinor, shprehja gjinore, orientimi seksual ose karakteristikat seksuale të një personi;
- ç) shmangies së stereotipave gjinorë në veprimtarinë e vet;
- d) shmangjes dhe mosshfaqjes së komunikimeve apo reklamave tregtare audiovizive që shkaktojnë dëm psikologjik ose fizik, apo edhe çrregullime të të ngrënit, si anoreksia, veçanërisht tek vajzat dhe gratë e reja, si dhe informacione e reklama lidhur me planifikimin familjar, të drejtat seksuale dhe riprodhuese, shëndetin e nënës dhe fëmijës dhe edukimin, që iu drejtohen sa grave/vajzave aq edhe burrave e djemve.
- dh) shmangies dhe mosshfaqjes së portretizimeve seksiste dhe diskriminuese, me bazë gjinore.

- 2. Ndalohet transmetimi, botimi dhe publikimi i materialeve dhe i informacioneve, që përmbajnë apo nënkuptojnë dallime seksiste, poshtëruese apo fyese, përjashtime apo kufizime të njëjës prej gjinive, në bazë të diskriminimit për shkak të gjinisë.
- 3. Autoriteti i Medias Audiovizive si dhe operatorët e medias audio-vizive miratojnë plane vjetore për ndërgjegjësimin dhe forcimin e kapaciteteve për seksizmin dhe barazinë gjinore në mediat audiovizive. Planet shpallen publikisht dhe një përmbledhje e realizimit të tyre publikohet në fund të çdo viti, përfshirë edhe në faqet e tyre të internetit.

- ✓ Në nenin 28, Gjoha, ndryshohet pika 1 dhe përfshihet pika 2/1 në tërësinë e kundërvajtjeve, si vijon:

1. Shkelja e neneve 15, 16, 17, 18 pika 2 shkronjat “a” dhe “c” dhe 20 pika 3 të këtij ligji dënohen me gjobë nga Inspektorati Shtetëror i Punës.

2/1 Shkelja e nenit 26 të këtij ligji, për sa lidhet me median audiovizive,

*përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga Autoriteti i Medias Audiovizive.*

5. Në Ligjin nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare”, me qëllim zhvillimin e programeve statistikore për çëshjet gjinore, sugjerohet ndryshimi si vijon:

Neni 4, “Parimet e statistikave zyrtare”, sugjerohet të përfshijë në tërësinë e parimeve atë të barazisë gjinore, si vijon:

*“Për të siguruar cilësinë e statistikave zyrtare dhe besueshmërinë e publikut në to, prodhuesit e statistikave zyrtare udhëhiqen nga parimet e Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane, përfshirë atë të barazisë gjinore”*

6. Në Ligjin Nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim adresimin e reklamave seksiste në fushatat zgjedhore, sugjerohet ndryshimi në ligjin për zgjedhjet si vijon:

Në nenin 4, “Ligji zgjedhor dhe barazia gjinore”, sugjerohet shtimi i pikës 3 si vijon:

*“Ndalohen reklamat apo fushatat zgjedhore, që pasqyrojnë sjellje seksiste, objektifikuese, stereotipizuese, degraduese ose fyese të kandidatëve apo cilitdo personi të përfshirë, apo që pasqyrohet përmes tyre”.*

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor, parashikuar nga neni 22 i Ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

**AVOKAT I POPULLIT**

**Erinda BALLANCA**